

15-vjetori i krijimit të Gjykatës Kushtetuese

Fjala e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese Dr. Vladimir Kristo

I nderuar Zoti President i Republikës

Të nderuar pjesëmarrës

Gjykata Kushtetuese Shqiptare mbushi 15 vjet. Është një arsye mjaft e mirë për të festuar këtë ditëlindje. Është nder dhe kënaqësi që jeni me ne për ta kujtuar së bashku këtë përvjetor. Në emër të Gjykatës Kushtetuese ju falenderoj për zemërsisht për praninë Tuaj në këtë ngjarje.

Të nderuar zonja dhe zotërinj

15 vjet më parë, pak kohë pas ndryshimeve demokratike, u miratua nga Kuvendi i atëhershëm paketa e ligjeve kushtetuese që do të shënonte kalimin e Shqipërisë, nga një sistem qeverisje totalitar në një sistem demokratik. Një nga synimet e shtetit të ri demokratik ishte dhe miratimi i një kuadri kushtetues bashkëkohor, sipas parimeve të shteteve demokratike, i cili do të sanksiononte parimin universal të ndarjes së pushteteve duke përcaktuar si qëllim kryesor, mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Ishin këto arsyet që shërbyen si nxitje për krijimin e Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë, sikundër kishte ndodhur më parë edhe në vende të tjera të Europës Lindore si në Poloni, Hungari, Kroaci, Rusi, Slloveni, Bullgari, Rumani, Maqedoni, etj. Me diferenca jo aq të ndjeshme, roli, kompetencat dhe juridiksioni i këtyre gjykatave, të ngritura sipas modelit të ideuar nga konstitucionalisti i shquar Hans Kelzen, janë përafërsisht të njëjta me gjykatat kushtetuese të Europës Perëndimore.

Krijimi dhe veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese në Shqipëri ashtu si dhe ajo e Gjykatave Kushtetuese të vendeve ish- socialiste, ka qenë një faktor i rëndësishëm pozitiv, në procesin e vështirë të shkëputjes nga e kaluara dhe për

t'u orientuar drejt ndërtimit të një shoqërie të vërtetë demokratike. Vendimet e dhëna nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, për nga karakteri dhe rëndësia e tyre, brenda kësaj periudhe relativisht të shkurtër të ekzistencës së saj, janë pikërisht dëshmi e këtij orientimi dhe zhvillimi demokratik.

Si në çdo fushë që lëvrohet për herë të parë, edhe veprimtaria vendimmarrëse e Gjykatës Kushtetuese është shoqëruar me vështirësi dhe është dashur kohë që ajo të kalojë etapat e rritjes dhe të konsolidimit të saj si institucion, krahas institucioneve të tjera të shtetit të ri demokratik shqiptar. Gjatë rrugës 15 vjeçare të veprimtarisë, në sajë të përpjekjeve të të gjithë anëtarëve e stafit administrativ, si dhe të vullnetit të mirë politik për të mbështetur veprimtarinë e këtij institucioni, Gjykata Kushtetuese ka mundur të krijojë fizionominë e saj, të sigurojë integritetin dhe pavarësinë institucionale, të rradhitet krahas gjykatave simotra të vendeve të tjera dhe të japë kontributin e saj për konsolidimin e shtetit të së drejtës, në përpjekje të përbashkëta me institucionet e tjera të shtetit shqiptar e të shoqërisë shqiptare për integrimin euroatlantik të vendit.

Në varësi të bazës kushtetuese, veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese mund të ndahet në dy etapa. Në etapën e parë 1992-1998 veprimtaria e saj është mbështetur në Dispozitat Kryesore Kushtetuese. Në këtë etapë edhe pse pa përvojën e duhur, kjo Gjykatë arriti të bëjë zgjidhje në përputhje me dispozitat kushtetuese dhe parimet bazë të shtetit të së drejtës, duke vendosur kështu gurët e parë të themelit të një praktike ,që u konsolidua më pas në etapën e dytë me fuqizimin e kontrollit kushtetues të ligjeve dhe të akteve të tjera normative.

Që në fillimet e veprimtarisë së saj vendimmarrëse, Gjykata Kushtetuese është përpjekur jo vetëm të afirmojë parimet e përgjithshme të së drejtës kushtetuese, por edhe t'i përdorë këto, për të vlerësuar pajtueshmërinë ose jo të akteve që ka marrë në shqyrtim, me Dispozitat Kryesore Kushtetuese në fillim dhe me Kushtetutën më pas. Ndër to mund të përmendim parimet e shtetit të së drejtës, të ndarjes e të balancimit të pushteteve, të sigurisë juridike, të vetqeverisjes vendore, të unitetit të pushtetit, parimin e mosdiskriminimit, të barazisë para ligjit, etj.

Gjykata Kushtetuese ka lënë pas një histori të larmishme, duke filluar nga shqyrtimi i çështjeve të konfliktit të kompetencave midis pushteteve, të kthimit dhe kompensimit të pronave ish- pronarëve, çështje të pavarësisë së gjyqësorit, kushtetutshmërinë e objektit dhe veprimtarisë së komisioneve hetimore parlamentare, kushtetutshmërinë e referendumit, etj, duke mos lënë pa përmendur këtu kërkesat e qytetarëve për kundërshtimin e akteve që çenojnë të drejtat e tyre për një proces të rregullt ligjor.

Gjykata Kushtetuese për vetë natyrën dhe objektin e vendimmarrjes, megjithëse qëndron jashtë politikës, shpesh tërheq vëmendjen e politikës. Vendimet e saj në një pjesë të tyre kanë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen politike të organeve të pushtetit shtetëror. Vendimet e kësaj Gjykate ndikojnë në përcaktimin e mënyrës sesi politika duhet të sillet në raport me organe të caktuara.

Në këtë rast nuk e kam fjalën vetëm tek interpretimet kushtetuese lidhur p.sh me veprimtarinë e komisioneve hetimore apo zgjedhjet parlamentare, por edhe për çështje të kushtetutshmërisë së ligjeve që rregullojnë funksionimin e organeve kushtetuese apo raportet midis tyre.

Gjykata Kushtetuese është e ndërgjegjshme për përgjegjësinë që ka në dhënien e vendimeve të tilla, prandaj edhe çdo gjyqtar kushtetues, në rradhë të parë si qytetar e pastaj në funksionin që ushtron, i mendon e duhet t'i mendojë edhe pasojat që mund të sjellë vendimi në jetën politike të vendit. Natyrisht është detyrimi ynë që t'i shmangemi çdo lloj subjektivizmi, me qëllim që vendimet t'i japim jo mbi kritere politike por mbi kritere të mirëfillta juridike. Gjykata Kushtetuese në asnjë rast nuk mund të rekomandojë zgjidhjen më të mirë politike në një situatë të caktuar, ajo vetëm shprehet se çfarë i lejohet politikës nga pikëpamja kushtetuese dhe ligjore dhe çfarë jo. Dhe në këtë rast Gjykata është e vetëdijshme se çdo organ që ka kompetenca pushteti, nuk ka dëshirë të dëgjojë se çfarë nuk i lejohet, por në fund të fundit kjo është detyra dhe funksioni i kësaj Gjykate.

Organet e pushtetit shtetëror kanë kompetenca të ndryshme dhe shteti i së drejtës funksionon si një i tërë, vetëm atëherë kur secili prej organeve respekton

kufijtë e kompetencave të veta dhe raportet me pushtetet e tjera. Kontrolli kushtetues është padyshim kontrolli i pushtetit politik, kjo ka qenë dhe filozofia mbi bazën e së cilës u krijua Gjykata Kushtetuese për herë të parë në Austri. Në aspektin vendimmarrës, deviza e Gjykatës Kushtetuese ka qenë dhe mbetet, se askush nuk mund të qëndrojë mbi Kushtetutën dhe ligjin. Në të njëjtën kohë ajo është përpjekur të jetë shumë e vëmendshme, që besimi i publikut ndaj vendimeve të saj të vijë në rritje, duke bërë kujdesin maksimal, që kontrolli i saj kushtetues të mos shmangë organet e tjera kushtetuese, në ushtrimin e pavarur të kompetencave të tyre. Ideja e shtetit të së drejtës për realitetin shqiptar është ende në konsolidim e sipër, prandaj i takon edhe Gjykatës Kushtetuese të kujdeset për forcimin e tij, sidomos gjatë kontrollit që ajo ushtron ndaj akteve juridike të pushtetit ekzekutiv, legjislativ apo gjyqësor. Është e njohur shprehja e ish Kryetarit të Gjykatës së Lartë të SHBA, z. Hughes se :” **Ne i nënshtrohemi Kushtetutës por Kushtetuta është ashtu si e interpretojnë gjyqtarët(We are under the Constitution but the Constitution is what the judges say it is)**”. Është pikërisht kjo filozofi që duhet të përshkojë qëndrimin jo vetëm të Gjykatës Kushtetuese, por edhe të palëve që përfshihen në një proces kushtetues. Kjo është një arsye më shumë për përgjegjësitë e mëdha të kësaj Gjykate në vendimmarrje.

Në këto 15 vjet ka pasur arritje jo vetëm në aspektin vendimmarrës të kësaj Gjykate. Ajo arriti me përpjekje të vazhdueshme të përcaktonte qartë statusin në raport me organet e tjera si dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e saj. Detyrimi për të zbatuar vendimet e formës së prerë të kësaj Gjykate është kuptuar pothuaj nga të gjithë subjektet e përfshira direkt ose indirekt në vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese. Në këtë drejtim kjo Gjykatë ka dhënë shembullin e saj, kur pak kohë pas daljes së vendimit të GJEDNJ, lidhur me qënien e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si element i procesit të rregullt ligjor, ndryshoi praktikën e saj të deriatëhershme në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi. Ky reagim i menjëhershëm është vlerësuar dhe përshëndetur nga institucionet përfaqësuese të Këshillit të Europës. Ky qëndrim i ri duhet të shoqërohet me një angazhim më serioz të

zyrave të përbarimit të ngarkuara me ligj për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat shpesh mjaftohen me kryerjen e veprimeve formale, pa zbatuar me vendosmëri kompetencat e tyre, që nga sekuestrimi i fondeve e gjer në vënien para përgjegjësisë administrative e penale të personave që pengojnë ekzekutimin e vendimeve. Gjykata Kushtetuese jo vetëm në këtë rast, por në mënyrë të vazhdueshme i referohet praktikës së Gjykatës së Strasburgut, e cila si një gjykatë supranacionale mbetet një udhërrëfyese për të gjitha gjykatat e tjera nacionale. Gjykata Kushtetuese gjithnjë e më shumë i referohet rasteve konkrete, që lidhen me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individit nga GJEDNJ.

Sikundër jeni në dijeni, kohët e fundit GJEDNJ ka filluar të marrë gjithmonë e më shumë në shqyrtim vendime të gjykatave shqiptare dhe në disa raste ka penalizuar shtetin tonë me gjoba dhe dëmshpërblime. Këto vendime janë objekt i studimit të kujdesshëm nga ana jonë, jo vetëm për të përfituar profesionalisht, por edhe për të evidentuar qëndrimet tona, në ato raste kur çështjet kanë qenë objekt gjykimi nga Gjykata Kushtetuese. Do të sugjeronim që në raste të tilla edhe në gjykatat e sistemit gjyqësor, vendimet e Gjykatës së Strasburgut të bëhen objekt analize, ashtu sikundër do të sugjeronim që këto vendime të zenë më shumë vend në programet e trajnimit vazhduesh të Shkollës së Magjistraturës. Njohja e tyre përbën një domosdoshmëri, sepse shmangia e gabimeve në zbatimin e ligjeve jo vetëm që eviton shkeljen e të drejtave të njeriut, por edhe për faktin se penalizimet rëndojnë në analizë të fundit tek taksapaguesit shqiptarë, të cilët paguajnë për gabimet e gjyqtarëve.

Në përputhje me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese ka vetëm kompetencën e shfuqizimit të akteve që shqyrton, pra ajo vepron si ligjvënës negativ. Kjo do të thotë se u takon organeve shtetërore përkatëse të plotësojnë boshllëkun ligjor që krijohet nga ky shfuqizim. Eksperienca 15 vjeçare e Gjykatës Kushtetuese ka treguar se jo gjithnjë organet shtetërore veprojnë me shpejtësinë e duhur për të bërë plotësimet e legjislacionit dhe në raste të veçanta, ky plotësim nuk ka qenë në përputhje të plotë me konkluzionet dhe përmbajtjen e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Është e kuptueshme se legjislacioni që bie

ndesh me standardet kushtetuese cënon rëndë, si të drejtat e njeriut ashtu dhe interesat e shtetit të së drejtës. Sa më shumë të zgjasë zbatimi i një ligji antikushtetues, aq më shumë do të cënohen këto interesa dhe aq më të rënda do të jenë pasojat që mund të vijnë, të cilat nuk mund të riparohen nga Gjykata Kushtetuese edhe në rastet kur ligji shfuqizohet. Eksperienca e këtyre viteve tregon se Gjykatës Kushtetuese i duhet të jetë e vëmendshme për të zbatuar, kur është rasti, kompetencat e saj ligjore të pezullimit të zbatimit të aktit normativ. Ndryshe nga sa ka ndodhur në ndonjë rast, ky veprim duhet përshëndetur nga organet shtetërore kompetente, të cilat lipset të marrin masat për ndërprerjen e gjendjes së paligjshmërisë në funksion të mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave themelore të shtetasve dhe të interesave madhore të shtetit shqiptar që aspiron të integrohet sa më parë në strukturat euroatlantike.

Megenëse kontrolli i Gjykatës Kushtetuese mbi vendimet gjyqësore të formës së prerë zë vendin më të madh në veprimtarinë e saj, më lejoni ta cek pak edhe këtë aspekt. Shumëkush nga të pranishmit mban mend debatin midis Gjykatës së Lartë edhe Gjykatës Kushtetuese lidhur me kufirin e kontrollit të tyre. Ndërsa Gjykata e Lartë është gjykata më e lartë në sistemin gjyqësor që zgjidh konfliktet dhe interpreton përfundimisht ligjin, Gjykata Kushtetuese është organi që interpreton përfundimisht Kushtetutën. Por a është kaq e thjeshtë të përcaktosh se ku mbaron ligji dhe ku fillon Kushtetuta? Natyrisht që jo. Kushtetuta i ka njohur Gjykatës Kushtetuese atributin për të ushtruar kontroll mbi kushtetutshmërinë e vendimeve të gjykatave të zakonshme mbi bazë të një rekursi individual, ose më saktë Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një proces të rregullt ligjor (*neni 131/f i Kushtetutës*). Ndoshta është ky rregullim kushtetues që ka krijuar probleme, në ndonjë rast edhe keqkuptime, që shkojnë deri aty sa disa të shtrojnë pyetjen a është sistemi gjyqësor shqiptar me tre apo me katër shkallë?! Megjithëse ky debat tashmë paraqitet i kapërcyer, sipas mendimit tim, një rregullim më i mirë i dispozitës kushtetuese në fjalë, do ta bënte më efikente veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit të cilët,

ndryshe nga shumë vende të tjera, nuk kanë të drejtë t'i drejtohen drejtpërdrejt Gjykatës Kushtetuese, sa herë që mendojnë se u shkelen këto të drejta, pa shterur më parë të gjitha mjetet nëpërmjet një procesi të rregullt ligjor që mund të jetë gjyqësor apo administrativ.

Veprimtaria e Gjykatës Kushtetuese është përshëndetur dhe nga institucionet ndërkombëtare. Vlerësimi i bërë në Raportin e Komisionit Europian i publikuar më 6 nëntor 2007, se: “ **Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë kontribuar në zhvillimin e jurisprudencës për decentralizimin, në rolin e komisioneve hetimore parlamentare, rolin e pushtetit ekzekutiv në raport me organet e pavarura shtetërore, si dhe në standardet për nxjerrjen e akteve normative**” është një inkurajim që dhe në të ardhmen kjo Gjykatë të përsosë jurisprudencën e saj në funksion të garantimit të respektimit të Kushtetutës, forcimit të shtetit të së drejtës dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut

Pas kësaj paraqitjeje të shkurtër të arritjeve, mund të lindë pyetja : A ka kjo Gjykatë të meta në praktikën e saj. Natyrisht. Ç'farë mund të kishte bërë më mirë kjo Gjykatë ? Mjaft. Kështu, rezerva ka patur në arsyetimin e vendimeve të saj, sidomos të kolegjeve. Ka patur dhe raste kur Gjykata ka ndryshuar praktikën e saj. Kjo nga disa është cilësuar si mbështetje e interesave të caktuara ose si paqëndrueshmëri apo papjekuri në vendimmarrje. Nga të tjerë është konsideruar si rritje e Gjykatës me kalimin e viteve ose si përpjekje për të realizuar atë që quhet vetpërbajtje. Pavarësisht nga gabimet që janë të natyrshme në veprimtarinë e çdo organi, po të kemi parasysh edhe moshën relativisht të re të saj, mund të themi se Gjykata Kushtetuese Shqiptare ka krijuar tashmë jurisprudencën e saj dhe përfaqëson një organ me integritet në piramidën e institucioneve kushtetuese të vendit.

Gjykata Kushtetuese ka zbatuar në vazhdimësi parimin e transparencës së institucionit për publikun e gjerë, për masmediat, shoqërinë civile dhe individët. Gjykata ka synuar të sensibilizojë opinionin publik mbi domosdoshmërinë e sundimit të ligjit, një detyrë që kërkon angazhimin e të gjithë aktorëve të shoqërisë shqiptare, duke patur parasysh shprehjen brilante të Abraham Linkolnit

që theksonte se: “ **Nderimi për ligjin le t’i mëkohet nga çdo nënë amerikane foshnjës që belbëzon në prehërin e saj, le të mësohet në shkolla, në seminare dhe në kolegje, le të predikohet nga katedrat, të shpallet në sallat e ligjëvënies dhe të detyrohet në gjyqe** ”.

Përveç përmbushjes së detyrimit kushtetues për të botuar vendimet në Fletoren Zyrtare, Gjykata ka botuar dhe përmbledhjen vjetore të tyre. Veç kësaj Gjykata mirëmban një faqe interneti ku, përveç bazës kushtetuese e ligjore gjejnë pasqyrim edhe vendimet më të fundit të saj.

Që nga koha e themelimit, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur marrëdhënie të bashkëpunimit me Komisionin e Venecias, i cili ka dhënë ndihmesë të çmuar si me asistencën e tij për hartimin e ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e Gjykatës Kushtetuese, ashtu edhe në gatishmërinë për të dhënë opinione shkencore për çështje delikate e të ndërlikuara në shqyrtim (të ashtuquajtura *amicus curiae*). Në kuadër të këtij bashkëpunimi, Gjykata Kushtetuese kontribuon periodikisht e sistematikisht në pasurimin e bazës informatike të të dhënave të jurisprudencës kushtetuese të vendeve anëtare të Komisionit të Venecias. Kjo bazë të dhënash shfrytëzohet nga Gjykata për t’u njohur me vendimet më të rëndësishme të gjykatave kushtetuese të këtyre vendeve (që përbëjnë rreth 5000 përmbledhje vendimesh dhe tekste të plota). Vendimet më të rëndësishme të gjykatave kushtetuese anëtare, përfshirë edhe vendime të Gjykatës tonë, gjejnë dritën e botimit në Buletinin e Jurisprudencës Kushtetuese të Komisionit të Venecias. Gjykata ka zhvilluar dhe ka marrë pjesë në veprimtari shumëpalëshe të organizuara nga Komisioni i Venecias, siç kanë qenë seminare e simpoziume, konferenca tematike, mbledhje pune të ndërlidhësve të gjykatave kushtetuese, etj.

Në tetor të vitit 2000, ajo u pranua si anëtare me të drejta të plota në gjirin e Konferencës së Gjykatave Kushtetuese Europiane, si organizatë që bashkon gjykatat që kanë si kompetencë ushtrimin e kontrollit kushtetues ndaj ligjeve. Që nga kjo kohë, Gjykata merr pjesë aktive në veprimtarinë e kësaj organizate prestigjioze që bashkon gjykata kushtetuese të demokracive të reja e të vjetra. Në vijim të pranimit të Shqipërisë si anëtare shok e organizatës botërore të

Frankofonisë, Gjykata Kushtetuese pranohet, në janar 2002, anëtare me të drejta të plota e organizatës ACCPUF që bashkon gjykatat dhe këshillat kushtetuese të mbi 40 vendeve që përdorin edhe gjuhën frënge. Gjykata merr pjesë aktivisht në veprimtarinë e kësaj organizate.

Krahas pjesëmarrjes në këto organizata, Gjykata Kushtetuese ka qenë dhe është pjesë e Konferencës gjyqësore ndërkombëtare që bashkon mbi 80 gjykata kushtetuese dhe të larta të botës, në nismën e gjykatave kushtetuese të vendeve të Detit të Zi, në veprimtaritë e organizuara nga Instituti Gjerman për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar, etj.

Gjykata u ka kushtuar kujdes të veçantë marrëdhënieve dypalëshe me gjykatat kushtetuese, veçanërisht me ato të vendeve fqinjë. Kështu, janë zhvilluar veprimtari të përbashkëta tematike me Gjykatat Kushtetuese dhe organet analoge të Maqedonisë, Bullgarisë, Greqisë, Malit të Zi, Portugalisë, Francës, Belgjikës, SHBA, Austrisë, Gjermanisë, etj. Gjykata synon që këto marrëdhënie t'i shtrijë më tej në të ardhmen.

Të nderuar pjesëmarrës

Në këtë jubile të rëndësishëm, më lejoni të shpreh konsideratën dhe mirënjohjen time më të lartë për të gjithë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht për ata gjyqtarë kushtetues të cilët mund të quhen pionierët e kontrollit kushtetues në Shqipëri dhe që hodhën themelet e jurisprudencës kushtetuese shqiptare. E kam fjalën për gjyqtarët themelues të Gjykatës Kushtetuese, të cilët në fillimet e tyre duhet të përballëshin me mjaft vështirësi jo vetëm të natyrës juridike apo dhe politike, por edhe me probleme teknike të panumurta deri në përcaktimin e statusit të tyre, të denjë për institucionin që përfaqësojnë. Për ta historia e së drejtës kushtetuese do të ruajë përherë një vend nderi. Një homazh i veçantë i drejtohet atyre gjyqtarëve që nuk jetojnë më, duke filluar nga Manol Konomi, Feti Gjilani, Veli Budo dhe Bardha Selenica, të cilët, për kontributin e tyre shembullor do të mbeten të gjallë në memorien tonë.

Gjithashtu një falenderim i veçantë shkon tek të gjithë përfaqësuesit e pushtetit shtetëror, që ndër vite brenda kompetencave dhe mundësive praktike,

janë kujdesur në vazhdimësi që kjo Gjykatë të fitojë dhe të ruajë vendin e autoritetin që i takon dhe të përmbushë normalisht funksionet e saj.

Të nderuar zonja dhe zotërinj.

Prej shumë e shumë vjetësh në skenën juridike ndërkombëtare, herë pas here është shtruar pyetja: A mund të jenë gjyqtarët edhe ligjbërës ? Eshtë një pyetje që ka shoqëruar dhe ndezur debate në rradhët e juristëve. Një pjesë shtrimin e kësaj pyetjeje për diskutim e kanë quajtur absurditet, në rastin më të mirë papërgjegjshmëri ose injorancë, duke i qëndruar besnik qëndrimit tradicional se, gjyqtari vetëm mund të konstatojë dhe e shumta ta deklarojë antikushtetutshmërinë e ligjit. Në këtë çështje më ngacmoi pak praktika e Gjykatës Kushtetuese në vitet 1992-1998 kur kjo Gjykatë, në disa raste, ndryshe nga qëndrimi i mbajtur prej saj në vitet post-kushtetutë, ka luajtur rolin e ligjvënësit pozitiv. Natyrisht këtu nuk është as vendi dhe as koha për të hapur një debat të ri për këtë çështje, por pavarësisht nga qëndrimet e mbajtura, pjesa dërmuese e juristëve dhe konstitucionalistëve janë në një mendje, se pavarësisht nga fakti se Gjykata Kushtetuese luan rolin e ligjvënësit negativ, ajo kontribuon aktivisht në krijimin e së drejtës. Ndonëse nuk “bën” ligjin, ajo i jep mesazhe pushteteve të tjera, në mënyrë të veçantë legjislativit, se ky apo ai ligj duhet ndryshuar. Ndërsa në rastet kur Gjykata Kushtetuese interpreton Kushtetutën, ajo përpiqet t’i japë zgjidhje paqartësive apo problemeve që paraqesin dispozitat objekt-interpretimi, duke dhënë mesazhe për çështje që janë të ndjeshme në zbatimin e saj praktik.

Vitin e ardhshëm Kushtetuta Shqiptare mbush 10 vjet. Z.Buquicchio, Sekretar i Komisionit të Venecias, me rastin e kremtimeve të 5 vjetorit të Kushtetutës shprehej se, në këto përvjetorë duhen bërë bilance, duke shtuar se :
” Kushtetuta nuk mund të jetë një tekst i ngurtësuar ...ajo ... është dhe duhet të jetë një tekst i gjallë ... të mos merret si një tekst që nuk mund ose nuk duhet të mbetet i pandjeshëm ndaj modifikimeve, ndaj amendamenteve”.

Eshtë një rast shumë i mirë për të gjithë ne, në mënyrë të veçantë për përfaqësuesit e politikës, komunitetin e juristëve, të shoqërisë civile, masmedias dhe botës akademike shqiptare, që të bëjmë një bilanc të tillë gjatë vitit në vazhdim dhe më pas, të diskutojmë bashkarisht në konferencën ndërkombëtare që Gjykata Kushtetuese Shqiptare parashikon të organizojë, në bashkëpunim me Komisionin e Venecias, me rastin e kësaj ngjarjeje të rëndësishme.

Edhe një herë ju falenderoj për pjesëmarrjen dhe vëmendjen tuaj.

Dhe tani kam nderin t'ia jap fjalën Presidentit të Republikës, Z.Bamir Topi

Tiranë, më 24.11.2007